



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 6 qershor 2012, në orën 14: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Liburn Aliu.

Munguan: Flora Brovina, Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Jakup Krasniqi- Kryetar i Kuvendit; Ramadan Avdiu, zëvendësministër i Financave; Sahit Dragaj- Partia e Pensionistëve të Kosovës, Fahri Buçinca, Hasan Berisha, Sabri Kadriu, Naser Avdiu; Eshref Shabani- sekretar i MPMS-së, Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi; Florie Kryeziu- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim i Komisionit me Kryetarin e Kuvendit, ministrin e Financave, ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar, përfaqësuesit e Bankës Botërore, përfaqësuesit e pensionistëve;**
- Çështja e pensioneve, mundësitë për përmirësimin e situatës në këtë fushë**
- 3. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takim i Komisionit me Kryetarin e Kuvendit, ministrin e Financave, ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, përfaqësuesit e pensionistëve; Çështja e pensioneve, mundësitë për përmirësimin e situatës në këtë fushë

Fikrim Damka- E hapi mbledhjen duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në këtë takim dhe Kryetarin e Kuvendit për iniciativën e marrë për organizimin e këtij takimi. Projektligji për skemat pensionale, të financuara nga shteti, është kthyer nga Kuvendi për ripunim në Qeveri. Duke e ditur gjendjen e rëndë të pensionistëve, ne jemi takuar në përpjekje për ta gjetur një zgjidhje.

Jakup Krasniqi- Duke i përshëndetur të pranishmit, tha se qëllimi i këtij takimi është që të punojmë në drejtim të miratimit të një ligji brenda mundësive të Qeverisë, dhe po ashtu, të shikojmë mundësinë e krijimit të një fondi për pensionet. Pensionistëve u është bërë një padrejtësi. Pensionet që ata marrin nuk i plotësojnë nevojat e tyre. Po ashtu, buxheti ynë vështirë të ofrojë diçka më shumë në këtë drejtim. Komisioni parlamentar të bisedojë me Qeverinë, me pensionistët, FMN-në, BB-në, për ta gjetur një zgjidhje, për një financim të qëndrueshëm për pensionet. Si propozim, mund të ndahet një përqindje nga fondi i privatizimit, një përqindje nga të punësuarit në dy e më shumë punë. Po ashtu, duhet që edhe të punësuarit të solidarizohen për gjeneratën e pensionistëve. Është humane që gjenerata të punojë për gjeneratën. Kjo është njëra nga mënyrat e krijimit të një fondi për pensionistët. Pensionistët e meritojnë një pension më të dinjitetshëm, sesa ky që aktualisht e marrin.

Fahri Buçinca- Tha se pensionistët janë në gjendje shumë të vështirë. Për këtë kemi protestuar disa herë. Pensionistët kanë filluar të vetorganizhen, sepse e kanë humbur besimin në struktura të pensionistëve. Ne nuk jemi për protesta në rrugë, por jemi për atë që ta shqyrtojmë këtë problem në mënyrë institucionale. Jemi takuar me shumë përfaqësues të institucioneve, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së pensionistëve. Ligji për pensionet është diskriminues. Është keq që nuk janë këtu sot me ne ministri i Financave dhe ministri i Punës.

Sahit Dragaj- Tha se pensionistët po përjetojnë atë që në asnjë vend tjetër nuk e kanë përjetuar. Ligji është shumë diskriminues. Kjo është e pakuptimtë. Duhet të bëhet një selektim më i mirë i pensinistëve si kategori e veçantë dhe jo të përzihen të gjithë në një kategori. Thuhet se nuk ka mjete. Të formohet një komision me ekspertë, në mënyrë që të verifikojë gjendjen dhe të shikojë mundësitë për dalje nga kjo situatë e vështirë. Në këtë Komision të jenë përfaqësuesit e pensionistëve. Nëse me të vërtetë nuk ka mundësi të rriten pensionet, atëherë edhe ne heqim dorë nga kërkesat tona.

Hasan Berisha- Tha se që nga viti 2005 e kemi një version të ligjit me implikime të mëdha financiare. Ky koncept që e prezantoi kryetari, është i pranueshëm dhe është i

njëjtë në esencë me propozimet tona që nga ajo kohë. Ligji që e kemi tash, nuk rregullon asgjë në mënyrë të duhur. Është ndarë buxheti për rritjen për 26 %, por nuk po realizohet ajo.

Sabri Kadriu- Tha se ky takim ka karakter historik. E drejta për pension është e drejtë jetësore. Kjo çka ndodhë tek ne, nuk ndodhë askund në Evropë. Shteti është shndërruar në pronë feudale. Indikator për vlerën e shërbimeve publike është rritja e punësimit dhe rritja e të ardhurave.

Naser Avdiu- Tha se duhet të punojmë më seriozisht, në mënyrë që këto probleme t'i zgjidhim sa më shpejt.

Eshref Shabani- Tha se kjo është çështje shumë e rëndësishme. Problemi kryesor është mungesa e mjeteve. Ne jemi të obliguar ta implementojmë programin qeveritar. Në aspektin teknik, MPMS-ja mund të hartojë çfarëdo ligji. FMN-ja ka dhënë disa sugjerime lidhur me këtë Projektligj. Mjetet e parapara për ngritje janë të ndara, por duhet një vendim qeveritar për të bërë shpërndarjen e tyre.

Ramadan Avdiu- E përshëndeti iniciativën për gjetjen e një zgjidhjeje për pensionet. Duhet të gjindet një zgjidhje imediate dhe, po ashtu, edhe një zgjidhje afatgjate. Nuk ka diskriminim. Të gjithë ata që kanë punuar e kanë një pension. Është shumë i vogël, por të tilla janë mundësitë tona. Sa i takon krijimit të fondit, duhet të shikohen mundësitë ligjore. Do të ketë pengesa ligjore për krijimin e këtij fondi. Projektligji i pensioneve duhet të kalojë në Kuvend dhe në këtë mënyrë të mund që në një fazë të mëvonshme ta modifikojmë këtë ligj.

Jan Peter Olters- Tha se bashkëndejmë situatën e pensionistëve në Kosovë. Në këtë sistem ka disa padrejtësi. Duhet të mos përkeqësohet situata e punësimit, por duhet të zgjerohen mundësitë për punësim. Roli ynë është vetëm këshillues në këtë drejtim. Ne nuk jemi ata që pengojmë. Por, duhet të kihet parasysh disa kritere, si për shembull: qëndrueshmërinë financiare, rritjen ekonomike dhe mirëqenien e pensionistëve.

Jakup Krasniqi- Tha se nga diskutimet shihet se askush nga ne nuk është i kënaqur me gjendjen në të cilën jemi në këtë fushë. Duhet ta gjejmë një zgjidhje të qëndrueshme. Duhet të organizohet një takim i përbashkët për gjetjen e kësaj zgjidhjeje. Duhet të gjinden edhe mundësitë ligjore për një gjë të tillë.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka